

Produkti i Brendshëm Bruto, 2013

Vlerësime finale 2012 dhe gjysëm finale 2013

Tiranë, më 29 Maj 2015: INSTAT paraqet për përdoruesit të dhënat vjetore finale të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2012 dhe gjysëm-finale për vitin 2013 sipas NVE 2.

Llogaritë Kombëtare në këtë publikim do të paraqesin për herë të parë të dhënat e PBB-së për vitet 2011-2013 sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Pas reflektimit të sistemit të ri të klasifikimit në të gjitha statistikatat e ndërmarrjeve dhe të punësimit, llogaritë kombëtare janë fusha e fundit statistikore që implementon klasifikimin e ri. Përditësimet e klasifikimeve bëhen që treguesit të jenë më të dobishëm për përdoruesit, të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe të përmirësojnë krahasueshmërinë e të dhënave midis vendeve të BE. Aktualisht, PBB paraqitet në 35 aktivitete ekonomike duke u detajuar më shumë në fushën e shërbimeve. Në muajin e ardhshëm, INSTAT do të përfundojë kalimin e gjithë sistemit të llogarive kombëtare sipas klasifikimit të ri NVE Rev.2, duke u plotësuar me seritë vjetore dhe tremujore të periudhave të mëparshme të treguesit të PBB-së, Llogarive rajonale dhe Tabelave të Burim-Përdorimeve. Për më shumë informacion shih informacion për përdoruesit fq 7.

Sipas të dhënave me bazë vjetore, PBB me çmime korente u vlerësua 1.350.555 milionë lekë (9.6 miliardë Euro) në vitin 2013 dhe 1.332.811 milionë lekë për vitin 2012 (9.5 miliardë Euro). Në vitin 2013, PBB në terma nominalë (në vlerë) u rrit me +1.33 %.

Në vitin 2013 ekonomia shqiptare shënoi një rritje në terma real (në volum) prej +1,11 % krahasuar me vitin 2012, pas një rritje prej +1,42 % në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011. Deflatori i PBB-së për vitin 2013 ishte +0,2 %. Mbështetur mbi këto rezultate, PBB për frymë në vitin 2013 arriti në 466 mijë lekë (ose 3.330 €) nga 460 mijë lekë (ose 3.276 €) që ishte në vitin 2012.

Sipas PBB-së me metodën e prodhimit, rritjet në terma real për degët kryesore të ekonomisë në vitin 2013, janë: *Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi* me +0,67 %, *Industria dhe Ndërtimi* +2,7 % dhe *Shërbimet* me +0,3 %. Peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2013 vazhdojnë ta zënë *Shërbimet* gjithsej me 44,6 % të PBB, pasuar nga *Industria dhe Ndërtimi* 23,0 % dhe *Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi* me 19,6 %.

Sipas PBB-së me metodën e shpenzimeve për vitin 2013, *Konsumi final* përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 88,93%. Ky komponent u rrit me +1,86 % në terma nominalë dhe +1,6 % në


terma reale. Në vitin 2013 *Formimi bruto i kapitalit fiks* përbën 25.92% të PBB-së dhe u ul me -2,1 % në terma reale krahasuar me vitin 2012. *Eksporti i mallrave dhe shërbimeve* u rrit në terma reale me +18,03 % krahasuar me vitin 2012. Ndërkohë që *Importet e mallrave dhe shërbimeve* rriten me një ritëm me +4,24 %

Tab.1 Treguesit kryesorë makroekonomikë (2012-2013 me çmime korente)

Treguesit		Vitet	
		2012	2013*
Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korente (në milion lekë)		1,332,811	1,350,555
Të ardhurat kombëtare bruto (në milion lekë)		1,322,728	1,353,368
Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante krahasuar me vitin e mëparshëm (në %)		1.42	1.11
Deflatori i PBB (në %)		1.0	0.2
Popullsia mesatare vjetore (në mijë banorë)		2,900	2,897
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	Mijë lekë	460	466
	EURO	3,276	3,330
	USD	4,349	4,419

2013* Të dhëna gjysëm-finale

Fig 1. PBB dhe rritja ekonomike, 2010-2013



Tab.2 Indekset e rritjes në vlerë dhe struktura e PBB me çmimet e tregut, 2012-2013

A35	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev. 2	Vlerat me çmime korente Në Milion Lekë		Indeksi i rritjes nominale (%)	Struktura e PBB (%)	
		2012	2013*		2012	2013*
A1	Bujqësi, pyje dhe peshkim	250,126	265,147	6.0	18.8	19.6
A2	Industria nxjerrëse	60,195	66,622	10.7	4.5	4.9
A3	Prodhimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit	10,197	9,360	-8.2	0.8	0.7
A4	Prodhimi i tekstileve, veshjeve; industria e lëkurës dhe këpucëve	17,446	19,347	10.9	1.3	1.4
A5	Prodhimi i produkteve prej druri, letre dhe të shtypshkrimit	6,286	5,213	-17.1	0.5	0.4
A6	Përpunimi i koksit dhe produkteve të naftës së rafinuar	(2,140)	(231)	-89.2	-0.2	0.0
A7	Industria kimike dhe e produkteve farmaceutike	1,679	1,610	-4.1	0.1	0.1
A8	Prodhimi i produkteve prej kauçuku, plastike dhe produkte të tjera minerale	11,384	11,703	2.8	0.9	0.9
A9	Prodhimi i produkteve metalike dhe me bazë metalike përveç makinerive	10,726	12,287	14.6	0.8	0.9
A10	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve	1,522	1,887	24.0	0.1	0.1
A11	Të tjera industri prodhuese, riparime dhe instalime të makinerive dhe pajisjeve	4,400	4,518	2.7	0.3	0.3
A12	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	22,298	27,795	24.7	1.7	2.1
A13	Prodhimi dhe furnizimi me ujë	4,953	5,054	2.0	0.4	0.4
A14	Kanalizime dhe menaxhimi e trajtimi i mbetjeve	4,720	4,970	5.3	0.4	0.4
A15	Ndërtimi	151,793	140,556	-7.4	11.4	10.4
A16	Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave	7,907	7,620	-3.6	0.6	0.6
A17	Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motorçikletave	83,543	85,237	2.0	6.3	6.3
A18	Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve dhe motorçikletave	52,120	54,228	4.1	3.9	4.0
A19	Transporti tokësor dhe me tubacione	26,637	22,120	-17.0	2.0	1.6
A20	Transporti ujor, ajror dhe magazinimi	24,199	17,214	-28.9	1.8	1.3
A21	Aktivite të postës dhe korrierës	5,333	4,666	-12.5	0.4	0.3
A22	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	24,533	23,079	-5.9	1.8	1.7
A23	Aktivite të publikimit, audiovizuale dhe transmetimit	10,924	9,895	-9.4	0.8	0.7
A24	Telekomunikimi	27,249	24,807	-9.0	2.0	1.8
A25	IT dhe të tjera shërbime informacioni	3,561	2,500	-29.8	0.3	0.2
A26	Aktivite financiare dhe të siguracionit	32,133	30,359	-5.5	2.4	2.2
A27	Aktivite të Real estate (Dhënies-Marrjes me qera)	79,883	86,402	8.2	6.0	6.4
A28	Aktivite ligjore dhe kontabiliteti, drejtimi, arkitekture dhe inxhinierie	22,144	24,022	8.5	1.7	1.8
A29	Kërkim dhe zhvillim shkencor dhe aktivite të tjera profesionale, shkencore e teknike	6,124	5,527	-9.7	0.5	0.4
A30	Aktivite administrative dhe shërbime mbështetëse	23,578	30,011	27.3	1.8	2.2
A31	Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyruar social	53,716	54,086	0.7	4.0	4.0
A32	Arsimi	57,694	61,256	6.2	4.3	4.5
A33	Shëndetësia dhe aktivite të punës sociale	33,255	34,893	4.9	2.5	2.6
A34	Arte, argëtim dhe çlodhje	11,809	10,080	-14.6	0.9	0.7
A35	Aktivite të tjera shërbimi dhe aktivite të familjeve	12,818	14,431	12.6	1.0	1.1
Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë		1,154,747	1,178,271	2.0	86.6	87.2
Taksa neto mbi produktet		179,559	175,651	-2.2	13.5	13.0
Subvencionet mbi produkte		(1,494)	(3,368)	125.4	-0.1	-0.2
PBB ME ÇMIMET E TREGUT		1,332,811	1,350,555	1.33	100.0	100.0

2013* Të dhëna gjysëm-finale

Tab.3 PBB me çmimet korente, të vitit të mëparshëm dhe rritja reale vjetore, 2012-2013


A35	Treguesit	Vlerat me çmime korente Në Milion Lekë		Vlerat me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)
		2012	2013*	2013*	2013*
A1	Bujqësi, pyje dhe peshkim	250,126	265,147	251,792	0.67
A2	Industria nxjerrëse	60,195	66,622	68,160	13.23
A3	Prodhimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit	10,197	9,360	9,339	-8.41
A4	Prodhimi i tekstileve, veshjeve; industria e lëkurës dhe këpucëve	17,446	19,347	19,061	9.26
A5	Prodhimi i produkteve prej druri, letre dhe të shtypshkrimit	6,286	5,213	5,257	-16.38
A6	Përpunimi i koksit dhe produkteve të naftës së rafinuar	(2,140)	(231)	(216)	-89.91
A7	Industria kimike dhe e produkteve farmaceutike	1,679	1,610	1,625	-3.20
A8	Prodhimi i produkteve prej kauçuku, plastike dhe produkte të tjera minerale	11,384	11,703	11,721	2.96
A9	Prodhimi i produkteve metalike dhe me bazë metalike përveç makinerive	10,726	12,287	12,628	17.72
A10	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve	1,522	1,887	1,791	17.67
A11	Të tjera industri prodhuese, riparime dhe instalime të makinerive dhe pajisjeve	4,400	4,518	4,355	-1.03
A12	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	22,298	27,795	30,388	36.28
A13	Prodhimi dhe furnizimi me ujë	4,953	5,054	4,941	-0.25
A14	Kanalizime dhe menaxhimi e trajtimi i mbetjeve	4,720	4,970	5,288	12.04
A15	Ndërtimi	151,793	140,556	139,411	-8.16
A16	Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave	7,907	7,620	7,500	-5.15
A17	Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motorçikletave	83,543	85,237	83,915	0.45
A18	Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve dhe motorçikletave	52,120	54,228	53,351	2.36
A19	Transporti tokësor dhe me tubacione	26,637	22,120	21,611	-18.87
A20	Transporti ujor, ajror dhe magazinimi	24,199	17,214	17,238	-28.77
A21	Aktivitetet të postës dhe korrierës	5,333	4,666	4,667	-12.49
A22	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	24,533	23,079	22,660	-7.63
A23	Aktivitetet të publikimit, audiovizuale dhe transmetimit	10,924	9,895	9,757	-10.68
A24	Telekomunikimi	27,249	24,807	24,713	-9.31
A25	IT dhe të tjera shërbime informacioni	3,561	2,500	2,457	-31.00
A26	Aktivitetet financiare dhe të siguracionit	32,133	30,359	32,676	1.69
A27	Aktivitetet të Real estate (Dhënies-Marrjes me qera)	79,883	86,402	87,158	9.11
A28	Aktivitetet ligjore dhe kontabiliteti, drejtimi, arkitektura dhe inxhinierie	22,144	24,022	23,570	6.44
A29	Kërkim dhe zhvillim shkencor dhe aktivitete të tjera profesionale, shkencore e teknike	6,124	5,527	5,424	-11.44
A30	Aktivitetet administrative dhe shërbime mbështetëse	23,578	30,011	29,445	24.88
A31	Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyruar social	53,716	54,086	54,500	1.46
A32	Arsimi	57,694	61,256	61,121	5.94
A33	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	33,255	34,893	34,725	4.42
A34	Arte, argëtim dhe çlodhje	11,809	10,080	10,125	-14.26
A35	Aktivitetet të tjera shërbimi dhe aktivitete të familjeve	12,818	14,431	14,224	10.96
Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë		1,154,747	1,178,271	1,166,376	1.01
Taksa neto mbi produktet		179,559	175,651	184,596	2.81
Subvencionet mbi produkte		(1,494)	(3,368)	(3,332)	123.01
PBB ME ÇMIMET E TREGUT		1,332,811	1,350,555	1,347,640	1.11

2013* Të dhëna gjysëm-finale

Tab. 4 Produkti i Brendshëm Bruto sipas metodës së Shpenzimeve, me çmime korente

		Vlerat me çmime korente		Indeksi i rritjes nominale (%)		Struktura e PBB (%)	
Treguesit e PBB-së		Në Milion Lek					
	2012	2013*	(2013/2012)	2012	2013*		
Konsumi Final	1.179.194	1.201.115	1,86	88,47	88,93		
Konsumi Final i Popullatës	1.032.478	1.052.092	1,90	77,47	77,90		
Konsumi Final i Administratës Publike	144.541	146.798	1,56	10,84	10,87		
Konsumi Individual	70.533	72.307	2,52	5,29	5,35		
Konsumi Kolektiv	74.008	74.491	0,65	5,55	5,52		
Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse	2.175	2.226	2,35	0,16	0,16		
Formimi Bruto i Kapitalit	353.044	350.085	-0,84	26,49	25,92		
Ndryshimet e gjëndjeve	24.522	42.733		1,84	3,16		
Mospërputhje statistikore	24.424			1,83			
Eksporti neto	- 248.372	- 243.525	-1,95	- 18,64	- 18,03		
Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	444.514	478.759	7,70	33,35	35,45		
Eksportet e mallrave	212.132	246.391	16,15	15,92	18,24		
Eksportet e shërbimeve	232.382	232.368	-0,01	17,44	17,21		
Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	692.887	722.284	4,24	51,99	53,48		
Importet e mallrave	490.029	487.641	-0,49	36,77	36,11		
Importet e shërbimeve	202.858	234.643	15,67	15,22	17,37		
PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO	1.332.811	1.350.555	1,3	100,00	100,00		

2013* Të dhënat janë gjysëm-finale

Fig 2. Struktura e PBB me metodën e Shpenzimeve, në %

Tab.5 Produkti i Brendshëm Bruto sipas metodës së Shpenzimeve me çmime konstante

Treguesit e PBB-së	Vlerat me çmime korente		PBB me çmime të vitit		Rritja reale (%)
			të mëparshëm		
	Në Milion Lek				
	2012	2013*	(2013/2012)	2013*	
Konsumi Final	1.179.193,6	1.201.115,2	1.197.543,1	1,6	
Konsumi Final i Popullatës	1.032.477,9	1.052.091,5	1.046.562,4	1,4	
Konsumi Final i Administratës Publike	144.540,9	146.797,6	148.742,7	2,9	
Konsumi Individual	70.532,6	72.306,8	74.218,6	5,2	
Konsumi Kolektiv	74.008,2	74.490,8	74.524,1	0,7	
Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse	2.174,8	2.226,0	2.238,0	2,9	
Formimi Bruto i Kapitalit	353.044,0	350.084,9	345.780,1	- 2,1	
Ndryshimet e gjëndjeve	24.522,0	42.733,1	52.216,1		
Mospërputhje statistikore	24.423,7				
Eksporti neto	- 248.372,3	- 243.525,2	- 247.898,8	- 0,2	
Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	444.514,4	478.759,0	479.580,7	7,9	
Eksportet e mallrave	212.132,1	246.390,6	246.186,0	16,1	
Eksportet e shërbimeve	232.382,3	232.368,3	233.394,7	0,4	
Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	692.886,7	722.284,2	727.479,5	5,0	
Importet e mallrave	490.028,9	487.641,2	496.825,9	1,4	
Importet e shërbimeve	202.857,8	234.643,0	230.653,6	13,7	
PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO	1.332.811,0	1.350.554,8	1.347.640,5	1,01	

2013* Të dhënat janë gjysëm-finale

Informacion për përdoruesin

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e PBB-së mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit European të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993.

Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit ose një tre-mujor). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare.

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë:

- Nomenklatura e veprimtarive ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomenklatura e produkteve (NP);
- Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit (COICOP);
- Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG).

Klasifikimi i veprimtarive ekonomike NVE Rev.2 është thelbësor për prodhimin, përpilimin dhe shpërndarjen e statistikave. Ky klasifikim statistikor është rishikuar herë pas here për të reflektuar zhvillimet ekonomike, teknologjike dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë e për të mundësuar krahasimin dhe lidhjen e të dhënave në nivel evropian dhe në përgjithësi, në atë botëror si pjesë e një sistemi të integruar. Klasifikimi i ri NVE Rev. 2 paraqet nivele më të larta të klasifikimit dhe detaje të reja të cilat reflektojnë forma të ndryshme të prodhimit si dhe industritë e reja në zhvillim (referoju Aneks 1 për detajimet sipas dy klasifikimeve).

Ndryshimet kryesore që sjellë klasifikimi i ri për aktivitetet ekonomike, janë si më poshtë:

- a. Sipas klasifikimit të vjetër (NVE Rev. 1) aktivitetet e “Publikimit” përkojnë me degën “ Industria e drurit, letrës, mobiljeve, printimit dhe publikimit”. Në klasifikimin e ri (NVE Rev. 2) “Aktivitete publikimi” është përfshirë në degën “Aktivitete të publikimit, audiovizuale dhe transmetimit”
- b. Në degën “Ndërtim” me NVE Rev.2 përveç aktivitetit të “Ndërtimit” në NVE Rev.1.1, përfshihen dhe “Punime të specializuara ndërtimi” të cilat me NVE Rev 1.1 përfshihej në degën “Aktivitete mbi pasuritë e patundshme”.

- c. Aktivitetet e postave dhe korrierës, që përkon në NVE Rev. 1.1, me degën “Posta dhe komunikacion” detajohet në dy aktivitete të veçanta sipas NVE Rev.2, në degën “Aktiviteti i postës dhe korrierës” dhe “Telekomunikimi”.
- d. Dega “Kanalizime dhe menaxhimi e trajtimi i mbetjeve” me NVE Rev.2 përkon me degën “Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale” me NVE Rev.1.1. Me klasifikimin e ri ky aktivitet ka kaluar në industri.
- d.Një pjesë e degës së “Tregti-së”, ajo e “Riparimi i artikujve personale dhe shtëpiake” me klasifikimin NVE Rev.1.1 ka kaluar në degën “Aktivitete të tjera shërbimi dhe aktivitete të familjeve” me NVE Rev.2.

Burimet e të dhënave

Për vlerësimet e PBB-së përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministritë, Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe të tjera. Duke krahasuar këto burime me njera-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë e cila është gjithëpërfshirëse, konsistente, koherente dhe tërësisht e integruar.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruar nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet, ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve; Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave; Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve; Anketa e Tregtisë me Pakicë; Anketa e Buxhetit të Familjeve; Anketa e Forcave të Punës; Anketa të matjes së nivelit të jetesës; Anketa të Statistikave të Çmimeve, etj.

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore; Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH); Statistika financiare monetare; Bilanci i Pagesave; Statistika fiskale të qeverisë; Statistika të tregtisë së jashtme; Të dhëna mbi energjinë elektrike dhe të produkteve energjitike; etj.

Fazat e publikimit dhe Politikat revizionuese

Vlerësimet e PBB-së vjetore kalojnë në tre faza llogaritjesh dhe publikimesh.

- Faza e parë është llogaritja paraprake vjetore e PBB të vitit (t) sipas të dyja metodave brenda njëmbëdhjetë muajve pas përfundimit të vitit (t+11) dhe bazohet në burime të të dhënave paraprake të Anketës Vjetore Strukturore pranë Ndërmarrjeve dhe burime administrative.

- Faza e dytë përfshin vlerësimet gjysëm-finale të llogarive vjetore të PBB të vitit "t" brenda gjashtë muajve pas vlerësimit paraprak ($t+17$). Llogaritjet gjysëm-finale bazohen në burime të dhënash më të plota dhe si rrjedhojë pothuajse tërësisht në metoda të drejtpërdrejta.
- Faza e tretë përfshin vlerësimet finale të PBB të vitit (t). Në këtë fazë të tretë rishikohen dhe njëherë të dhënat e vitit (t) kur vjen seti i të dhënave për vitin ($t+1$) me qëllim që të përfshihet çdo ndryshim i bërë për vitin (t) dhe të sigurohet konsistenca midis dy viteve të njëpasnjëshëm. Gjatë kësaj faze bëhet dhe bilanci final në nivel produkti midis dy metodave të PBB-së.

Të dhënat e publikuara revizionohen mbështetur në politikat revizionuese të llogarive kombëtare. Vlerësimet vjetore të Produktit të Brendshëm Bruto dhe komponentëve të tij janë subjekt i dy tipeve të revizionimit: të zakonshme dhe rastësore.

Revizionime të zakonshme:

Vlerësimi paraprak me baza vjetore të PBB (paraprake/flash) (viti t) është njëmbëdhjetë muaj (në fillim të Dhjetorit të vitit ($t+1$)). Vlerësimi mbështetet në të dhënat paraprake nga anketat dhe në disa raste në burime të tjera administrative. Një vlerësim i tillë rishikohet pas gjashtë muajsh në mënyrë që të marrim një vlerësim gjysëm-final. Në këtë moment rishikohen gjithashtu edhe vlerësimet e vitit të kaluar ($t-1$) për t'i kaluar nga vlerësime gjysëm-finale në finale.

Revizionime të veçanta:

Revizionimet e veçanta vijnë si rezultat i përfshirjes së burimeve të reja të të dhënave statistikore e administrative dhe përmirësimi i atyre ekzistuese; përmirësimit të teknikave statistikore dhe metodave të përpilimit të të dhënave për Llogaritë Kombëtare; ndryshimit të metodologjisë për shkak të standarteve të reja të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA dhe ESA).

Përkufizime

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB): Prodhimi i brendshëm bruto, vlerësuar me çmimet e tregut, është rezultati final i aktivitetit të prodhimit nga njësitë rezidente prodhuese gjatë një viti. Ai është llogaritur sipas dy mënyrave:

- **PBB me mënyrën e prodhimit**, është i barabartë me shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ndryshme të aktiviteteve, duke shtuar tatimet e taksat e duke i zbritur subvencionet mbi produktet (të cilat nuk u janë shpërndarë sektoreve apo degëve të aktivitetit);
- **PBB sipas mënyrës së shpenzimeve** është i barabartë me përdorimet finale të brendshme të produkteve e shërbimeve (konsumi final efektiv, formimi bruto i kapitalit fiks, ndryshimet e gjendjeve), plus eksportet, minus importet.

Prodhimi: Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte të shërbimeve për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proceset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim. Ekzistojnë tre lloje të prodhimit: prodhim tregu; prodhim i prodhuar për konsum final vetjak dhe prodhim tjetër jo-tregu.

Konsumi i ndërmjetëm: Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fiks.

Vlera e shtuar bruto: Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

PBB nominal mat vlerën e produkteve për një periudhë të caktuar kohore, me çmimet e periudhës në të cilin prodhohet produkti (çmimet e tanishme).

PBB reale mat produktin total të prodhuar në një ekonomi, për një periudhë të caktuar kohore, por duke marrë parasysh çmimet e një viti bazë (të dhënë-mundet me qene viti paraardhës ose cili vit caktohet si vit bazë).

Taksat mbi produktet dhe importin: Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa dhe taksa doganore mbi importet.

Subvencione në produkte: Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësive institucionale rezidente.

Konsumi Final: Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo Fitimprurëse që i Shërbejnë Familjeve (IJFPSf).

Konsumi final i familjeve: Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse: Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe NPISHs dhe vlerës së prodhimit tregtar.

Eksporti neto: Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b).

Formimi Bruto i Kapitalit Fiks: Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

Ndryshimi i gjendjeve: Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit. Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera; prodhime, punime shërbime në proces; produkte të gatshme e gjysëm të gatshme, mallra, kafshë, etj.

Çmim bazë: Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

Çmimet e tregut: janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

Çmime korente: Çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.

Çmime konstante: Vlerësimet me çmime konstante janë në vlerë reale pra të korrigjuara për ndryshimet në çmime në lidhje me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.

Aneks 1. Lidhja NVE Rev.1.1 dhe NVE Rev.2

Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev.1.1	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev.2
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura Peshkimi	Bujqësia, pyje dhe peshkimi
Nxjerrja e mineraleve energjitike Nxjerrja e mineraleve jo energjitike	Industria Nxjerrëse
Industria e përpunimit të drithërave Industri të tjera të produkteve ushqimore	Prodhimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit
Industria e tekstileve dhe lëkurës	Prodhimi i tekstileve, industria e veshjeve, industria e lëkurës dhe këpucëve
Industria e drurit, letrës, mobiljeve, printimit dhe publikimit	Prodhimi i produkteve prej druri, letre dhe të shtypshkrimit
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	Përpunimi i koksit dhe produkteve të naftës së rafinuar
Industria kimike dhe e kauçukut	Industria kimike dhe e produkteve farmaceutike
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	Prodhimi i produkteve prej kauçuku dhe plastike, dhe produkte të tjera minerale
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	Prodhimi i produkteve metalike dhe produkteve me bazë metalike përveç makinerive
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve Të tjera industri prodhuese, riparime dhe instalime të makinerive dhe pajisjeve
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	Energjisë elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar
Prodhimi dhe furnizimi me ujë	Prodhimi dhe furnizimi me ujë Kanalizime dhe menaxhimi e trajtimi i mbetjeve
Ndërtimi	Ndërtimi
Tregtia	Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorcikletave Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motorcikletave Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve dhe motorcikletave
Hotele dhe restorante	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor
Transport	Transporti tokësor dhe me tubacione Transporti ujor, ajror dhe magazinimi
Posta dhe komunikacion	Aktivitete të postës dhe korrierës Telekomunikimi
Aktivitete financiare	Aktivitete financiare dhe të siguracionit
Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qera dhe shërbime për ndërmarrjet	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qera Aktivitete të publikimit, audiovizuale dhe transmetimit IT dhe të tjera shërbime informacioni Aktivitete ligjore dhe kontabiliteti, drejtimi, arkitektura dhe inxhinierie Kërkim dhe zhvillim shkencor dhe aktivitete të tjera profesionale, shkencore e teknike Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse
Administrata publike dhe e mbrojtjes	Administrata publike dhe e mbrojtjes
Arsimi	Arsimi
Shëndeti	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	Arte, argëtim dhe çlodhje Aktivitete të tjera shërbimi dhe aktivitete të familjeve